

# INDEKSI I INTEGRITETIT TË ZGJEDHJEVE

## ZGJEDHJET VENDORE NË SHQIPËRI

21 QERSHOR 2015



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



**Dhoma**  
Zgjedhore

ZGJEDHJET VENDORE 21 QERSHOR 2015



FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHQIPËRINË

Anëtarë të Ekipit:

Roland Lami

Elda Mjollli Kapllani

Mirsada Hallunaj

Redaktor: Arjan Dyrmishi

© IDM, Tiranë 2014

---

ISBN: 978-9928-4123-6-2

Ky botim u mundësua me mbështetjen e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros, në kuadër të angazhimit me Dhomën e Situatës Zgjedhore. Përmbytja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim IDM dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Soros.

# INDEKSI I INTEGRITETIT TË ZGJEDHJEVE

## ZGJEDHJET VENDORE NË SHQIPËRI

21 Qershor 2015

Autorë

Arjan Dyrmishi  
Roland Lami  
Elda Mjolli Kapllani  
Mirsada Hallunaj

Tiranë  
Tetor 2015

## TABELA E LËNDËS

<b>SHKURTIME</b> .....	5
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	6
<b>I. HYRJE</b> .....	11
Metodologjia .....	12
Të dhënat e Përdorura .....	13
Llogaritja e të dhënave .....	15
Avantazhet dhe Kufizimet.....	17
<b>II. INDEKSI I INTEGRITETIT TË ZGJEDHJEVE</b> .....	18
Ligjet Zgjedhore .....	18
Procedurat Zgjedhore .....	20
Kufijtë e Zonave Zgjedhore .....	23
Regjistrimi i Partive Politike .....	24
Mbulimi i Fushatës nga Media .....	27
Financat e Fushatës .....	29
Procesi i Votimit .....	32
Numërimi i Votave .....	34
Pas zgjedhjeve .....	36
Autoritetet Zgjedhore .....	37
<b>III. INDEKSI I PËRFSHIRJES SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE</b> .....	39
Rëndësia e Përfshirjes së Shoqërisë Civile në Zgjedhje .....	39
Roli i Shoqërisë Civile Shqiptare në Zgjedhje .....	39
Numri i Organizatave të Përfshira dhe Shtrirja Gjeografike .....	40
Aktivitetet e Kryera.....	42
Mbështetja Fianciare.....	44
<b>IV. SHTOJCAT</b> .....	45
Shtojca 1. Metodologjia e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve.....	46
Shtojca 2. Vlerësimi për Nëntreguesit, Treguesit e Performancës dhe Indikatorët..	60
Shtojca 3. Raportet e Organizatave të Shoqërisë Civile mbi Zgjedhjet Vendore të 21 Qershorit 2015.....	71
Shtojca 4. Donatorët që kanë Financuar Projekte të OSHC për Zgjedhjet Vendore të 21 Qershorit 2015.....	73
<b>V. REFERENCAT</b> .....	75

## SHKURTIME

AIS -Instituti Shqiptar i Shkencave

BCCD - Qendra Ballkanike për Bashkëpunim dhe Zhvillim

BMM - Bordi Monitorimit të Medias

IDM - Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

ISP - Instituti Shqiptar i Studimeve Politike

IIZ - Indeksi i Integritetit të Zgjedhjeve

INFOÇIP - Qendra për Çështje të Informimit Publik

INSIZ - Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Zgjedhjeve

ISP - Instituti Shqiptar i Studimeve Politike

FML - Forumi i Mendimit të Lirë

KZAZ - Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor

KQV - Komisionet e Qendrave të Votimit

KZLN - Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme

KVV - Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

KShH - Komiteti Shqiptar i Helsinkit

OSHC - Organizatat të Shoqërisë Civile

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


Indeksi i Integritetit të Zgjedhjeve (IIZ) është një vlerësim i cilësisë së zgjedhjeve nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) Shqiptare. IIZ synon të kontribuojë në përmirësimin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe fuqizojë përfshirjen e shoqërisë civile në proceset demokratike në vend.

Në zgjedhjet e fundit vendore OSHC-të u përfshinë në një sërë aktiviteteve monitoruese, vlerësuese dhe advokimi, duke e rritur ndjeshëm aktivizmin e tyre. Në këtë mënyrë OSHC-të morën një përgjegjësi dhe rol më të madh në përpjekjet për përmirësimin e procesit zgjedhor dhe për konsolidimin e demokracisë në vend.

Numri i OSHC-ve të përfshira në këto zgjedhje ishte më i madh se në zgjedhje të mëparshme dhe përveç organizatave me qendër në Tiranë u përfshinë dhe një numër organizatash që veprojnë në qytete të tjera.

Mbështetja financiare për të mundësuar veprimtarinë e tyre ka ardhur pothuajse tërësisht nga donatorë të huaj. Mbështetja e OSHC-ve nga donatorë vendas mungoi pothuajse tërësisht në këto zgjedhje, megjithëse donacionet për partitë politike nga këta donatorë arritën në shifra shumë milionëshe.

IIZ vlerësoi zgjedhjet vendore të 21 Qershorit 2015 duke u mbështetur kryesisht në raporte të vëzhgimit të zgjedhjeve të përgatitura nga OSHC-të Shqiptare.



*Grafik 1. Rezultate e vlerësimit të 11 indikatorëve dhe tendenca e performancës*

Përveç se shpreh një zë të konsoliduar të aktorëve vendas IIZ përbën një alternativë të vlerësimeve nga monitoruesit ndërkombëtarë, por ndryshe nga këto vlerësime krijon një model më gjithëpërfshirës për vlerësimin a zgjedhjeve. Avantazhi i këtij modeli është se shmang qasjen bimodale të raporteve ndërkombëtare si të mira ose të këqija dhe ofron një mundësi vlerësimi më të mirë të progresit apo regresit në menaxhimin e zgjedhjeve.

Vlerësimi i zgjedhjeve sipas IIZ është kryer duke u mbështetur në 11 indikatorë dhe 47 tregues të performancës për secilin indikator. Indikatorët mbulojnë periudhën parazgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe periudhën pas zgjedhore. Indikatorët e vlerësimit janë: Ligjet Zgjedhore; Procedurat Zgjedhore; Kufijtë e zonave zgjedhore; Regjistrimi i Votuesve; Regjistrimi i Partive Politike; Mbulimi i Fushatës nga Media; Financat e Fushatës; Procesi i Votimit; Numërimi i Votave; Pas-zgjedhjeve; Autoritetet Zgjedhore.

Indikatorët vlerësohen me shkallë nga 1, që përbën shkallën më të ulët të

performancës, në 4 që është shkalla më e lartë. IIZ i vlerëson zgjedhjet vendore të 21 Qershorit 2015 në grafikun më poshtë sipas performancës së indikatorëve të përzgjedhur.

Përveç vlerësimit numerik Indeksi jep dhe trendin e ecurisë për secilin indikator sipas një kategorizimi me ngjyra i cili i korrespondon edhe katër vlerësimeve: dobët (1), mjaftueshëm (2), mirë (3), shumë mirë (4) (Grafiku 1).

Në mënyrë të përmbledhur vlerësimi për secilin indikator është si më poshtë:

1. Legjislacioni zgjedhor është i paplotë dhe jo tërësisht i qartë, ç'ka lejon aktorët e angazhuar në administrimin e procesit zgjedhor të marrin vendime të njëanshme dhe diskrecionale. Legjislacioni zgjedhor nuk është i pranuar gjerësisht dhe pjesëmarrja në miratimin e tij është e pjesshme. Mosharmonizimi i legjislacionit dhe kufizime të parashikuara në kodin zgjedhor kanë çuar në deformimin e konkurrencës dhe me pasoja veçanërisht për kandidatët e pavarur.
2. Zgjedhjet u menaxhuan relativisht mirë nga KQZ, por probleme të shumta u shfaqën me administratën zgjedhore në nivelet më të ulta. KQZ organizoi trajnimet e duhura për nivelet më të ulta të administratës zgjedhore dhe përmirësoi punën për informimin e zgjedhësve, përfshirë të rinjtë që votuan për herë të parë dhe minoritet. Megjithatë ndryshimet e shpeshta të përbërjes së komisioneve në nivelet më të ulta të administratës zgjedhore e dëmtuan respektimin e procedurave dhe cilësinë e zgjedhjeve në përgjithësi.
3. Megjithëse raportet e nxjerra nga OSHC-të nuk e kanë trajtuar gjerësisht kufijtë zgjedhorë, aspekte negative të evidentuara si mosbesimi i partive politike në drejtësinë e procesit të ndarjes administrative dhe mospranimi gjerësisht i procesit, krijimi i perceptimit se kufijtë kanë deformuar përfaqësimin, vështirësitë e krijuara për të planifikuar fushatën elektorale në mënyrë që të reflekttoheshin plotësisht ndryshimet e krijuara prej reformës territoriale administrative dhe mungesa e komunikimit të hollësishëm me zgjedhësit për efektet e saj nga subjektet politike konkurruese, ndikimi negativ në regjistrimin dhe zhvillimin e fushatës për partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur, përbëjnë disa nga treguesit kryesorë, të cilët kanë ndikuar negativisht në cilësinë e këtyre zgjedhjeve.
4. Regjistri zgjedhor ka nevojë të përmirësohet ndjeshëm, pasi listat



e votuesve kanë patur parregullsi të vazhdueshme. Gjithashtu ka patur probleme me informimin e zgjedhësve mbi listat. Jo të gjithë votuesit janë njoftuar paraprakisht se ku ishin caktuar për të votuar. Gjithashtu problematike mbetet votimi i emigrantëve shqiptarë në zgjedhje, gjë e cila e bën të vështirë për këta qytetarë që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar. Në këtë mënyrë është vështirësuar edhe verifikimi i saktësisë së Listës së Votuesve dhe llogaritja e shifrave të pjesëmarrjes reale të qytetarëve në votime.

5. Problemet e identifikuar në lidhje me regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve lidhen me mosrespektimin e afateve kohore të regjistrimit, fillimin e fushatës zgjedhore përpara regjistrimit të partive politike dhe kandidatëve, përzgjedhjen e kandidatëve nëpërmjet anashkalimit të procedurave dhe rregullave statutores të partive politike, vështirësi procedurale të krijuara nga vendime të marra nga KQZ.
6. Mediat shfaqën një shkallë të lartë të ndikimit nga partitë politike dhe grupet e interesit duke mos arritur të japin një mbulim të pavarur dhe të balancuar. Mbulimi mediatik i fushatës u përcaktua më shumë nga shkalla e ndikimit politik dhe mjeteve financiare të konkurrentëve se sa nga parimi i informimit të publikut. Një nga mangësitë kryesore ishte përçimi nga mediat e shkruara dhe televizive i lajmeve të prodhuara nga vetë partitë politike apo kandidatët në formën e transmetimeve të gatshme apo nëpërmjet marrjes së të dhënave nga rrjetet sociale, por pa verifikuar vërtetësinë e tyre. Përcaktimi i axhendës së mediave nga partitë politike dhe grupe të fuqishme të interesit u vërejt në fokusin pothuajse ekskluziv tek kandidatët për kryetarë bashkie duke lënë pothuajse të paraportuar informacione mbi kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiake, si dhe në mungesën e hapësirës së mjaftueshme mediatike për kandidatët e pavarur.
7. Indikatorit mbi financat e fushatës është më i ulët nga të gjithë indikatorët e analizuar. Partitë kanë përdorur financat si mjet për të ndikuar mbi votuesit duke tejkaluar shpenzimet e parashikuara nga buxheti për zgjedhjet. Megjithatë subjektet konkurruese dhe institucionet e ngarkuara me sigurimin e transparencës financiare të zgjedhjeve dështuan në mbledhjen, publikimin dhe vlerësimin e financimit të fushatës duke dështuar në të njëjtën mënyrë në dhënien

e transparencës së nevojshme. Në shumë raste ka patur përdorim të burimeve shtetërore në funksion të kandidatëve.

8. Gjatë ditës së zgjedhjeve nuk u evidentuan raste të frikësimit të votuesve për të ndikuar në shprehjen e lirë të vullnetit të tyre. Në përgjithësi votuesit nuk kanë patur vështirësi për të identifikuar qendrën e votimit dhe procedurat e votimit nuk kanë ndikuar negativisht në votim. Probleme ka patur me krijimin e lehtësirave për personat me aftësi të kufizuar, ndërsa ashtu si në zgjedhjet e mëparshme votuesit jashtë vendit nuk kanë mundësi votimi në vendet ku banojnë.
9. Nga pikëpamja kohore, procesi i numërimit të votave, shënoi përmirësim krahasuar me zgjedhjet e kaluara. Edhe pse vetëm në disa raste, parregullsitë në garantimin e respektimit të procedurave të sigurisë së kutive, ndikimet e jashtme nga njerëz të paautorizuar gjatë procesit të numërimit, mungesa e transparencës dhe krijimi i vështirësive për vëzhguesit e pavarur si dhe vonesat në publikimin e rezultateve bëjnë që numërimi i votave të marrë një vlerësim relativisht të ulët.
10. Rezultatet e zgjedhjeve u pranuan gjerësisht, por u evidentua një numër ankesash të paraqitura nga konkurruesit në institucionet e administrimit zgjedhor. Megjithatë ankesat kanë ndjekur rrugën ligjore dhe vendimet e marra janë pranuar. Autoritetet zgjedhore i trajtuan në kohë ankesat por disa ankesa i kanë pezulluar apo zgjidhur në mënyrë diskrecionale. Mandatet e të zgjedhurve u çertifikuan në kohë dhe nuk pati vonesa në formimin e institucioneve të zgjedhura. Nuk pati protesta të dhunshme apo forma të tjera të manifestimit publik.
11. Kompozimi i autoriteteve zgjedhore sipas parimit të emërimit nga partitë politike përbën një nga problemet kryesore të autoriteteve zgjedhore. Përkatësia politike e anëtarëve të autoriteteve zgjedhore ka bërë që vendimmarrja e tyre të ndikohet nga konsideratat dhe interesat e partive që përfaqësojnë dhe ka cënuar zbatimin me përpikmëri të legjislacionit zgjedhor. Përkatësia politike e anëtarëve të autoriteteve zgjedhore ka bërë që partitë të cilat nuk përfaqësohen në to të shohin me mosbesim paanshmërinë e tyre. Veprimtaria e autoriteteve zgjedhore kanë qenë pjesërisht transparente.

## I. HYRJE

Institucioni i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është një nga kriteret kryesore të demokracisë. Megjithatë, vetëm procesi i mbajtjes së zgjedhjeve nuk është i mjaftueshëm pa një qeverisje të mirë të zgjedhjeve, të cilat duhet të prodhojnë rezultate të besueshme dhe të pranueshme.

Në Shqipëri qeverisja e zgjedhjeve vazhdon të mbetet e dobët dhe pavarësisht reformave të vazhdueshme proceset nuk kanë arritur të krijojnë një sistem qeverisjeje të zgjedhjeve të aftë të prodhojë rezultate të besueshme dhe të pranueshme.

Përfshirja e shoqërisë civile në proceset zgjedhore ka rëndësi themelore në përmirësimin e cilësisë së zgjedhjeve dhe përgjatë dekadës së fundit shkalla e përfshirjes dhe roli i shoqërisë civile në proceset zgjedhore ka ardhur duke u rritur. Megjithatë përpjekjet e shoqërisë civile kanë qenë të fragmentuara dhe të pa koordinuara për të maksimizuar efektin e tyre.

Në këtë kontekst, IIZ shënon një përpjekje për të kontribuar më tej në përmirësimin e qeverisjes zgjedhjeve por edhe si një instrument për të konsoliduar dhe maksimizuar rolin e shoqërisë civile nëpërmjet koordinimit dhe konvergimit të veprimtarisë dhe aksioneve të tyre.

Nga ana tjetër IIZ synon të ofrojë një alternativë ndaj raporteve të vëzhgimit të zgjedhjeve të prodhuara nga organizatat ndërkombëtare. Megjithëse vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve ka ndihmuar në përmirësimin e zgjedhjeve, zgjedhjet kanë vazhduar të kenë të meta.

Pjesërisht kjo reflekton kufizimet e pashmangshme që ka vëzhgimi i zgjedhjeve nga misionet e huaja të vëzhgimit, pasi ato nuk mund ti detyrojnë partitë politike thellësisht të polarizuara të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin apo të mund të çrrënjosin praktikat jodemokratike dhe instinktin e përdorimit të çdo mjeti për mbajtjen e pushtetit apo ardhjen në pushtet.

Nga ana tjetër mungesa e aplikimit të një kuadri gjithëpërfshirës për vlerësimin e zgjedhjeve nga organizatat ndërkombëtare ka bërë që zgjedhjet të vlerësohen në aspektin bimodal si ‘të mira’ ose ‘të këqija’.

Për të adresuar këtë dobësi IIZ ofron një kuadër më gjithëpërfshirës, i cili

nxjerr në pah fushat e dobëta të administrimit të zgjedhjeve dhe lejon që në të ardhmen të mund të përqendrohen përpjekjet për përmirësimin e dobësive ndërkohë që synohet konsolidimi i treguesve të suksesshëm.

Nga ana tjetër vlerësimi i zgjedhjeve nga aktorë vendorë të shoqërisë civile jep mundësinë për të bërë vlerësime që shkojnë përtej korrektësisë politike të misioneve ndërkombëtare të vëzhgimit dhe mund të prodhojë aksion të mëtejshëm të shoqërisë civile i cili mund të vazhdojë edhe mbas zgjedhjeve.

### 1. Metodologjia

Për hartimin e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve është përdorur një metodologji e cila mat cilësinë e zgjedhjeve nëpërmjet njëmbëdhjetë indikatorëve të procesit zgjedhor që mbulojnë periudhën para zgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe periudhën pas zgjedhore.<sup>1</sup>


Njëmbëdhjetë indikatorët që mbulojnë fushat kryesore të vëzhguara dhe të monitoruara gjatë procesit të zgjedhjeve vendore 2015 janë si më poshtë:

1. Ligjet Zgjedhore
2. Procedurat Zgjedhore
3. Kufijtë e Zonave Zgjedhore
4. Regjistrimi i Votuesve
5. Regjistrimi i Partive Politike
6. Mbulimi i Fushatës nga Media
7. Financat e Fushatës
8. Procesi i Votimit
9. Numërimi i Votave
10. Pas-zgjedhjeve
11. Autoritetet Zgjedhore

---

<sup>1</sup> Për hartimin e kësaj metodologjie është marrë pikënisja nga Pippa Norris, Ferran Martínez i Coma and Max Grömping, "The Electoral Integrity Project, The Year in Elections, 2014" February, 2015. Megjithatë metodologjia është zbatuar duke e përshtatur për të bërë të mundur operacionalizimin e të dhënave dhe për të reflektuar disa aspekte të cilat janë vlerësuar si me relevante për kontekstin në Shqipëri.

Për të matur secilin indikator janë caktuar nga tre deri në gjashtë tregues të performancës. Në total janë dyzet e shtatë tregues të performancës. Secilit tregues performance i janë alokuar 102 nëntregues (Grafik 2, Shtojca 1).




*Grafik 2. Sasia e indikatorëve, treguesve të performancës dhe nëntreguesve*

## 2. Të dhënat e përdorura

Të dhënat e përdorura për hartimin e IIZ janë marrë nga 21 raporte të vëzhgimit të zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit 2015 të nxjerra nga OSHC-të (Shtojca 3). Kur ka qenë e nevojshme dhe e zbatueshme janë përdorur dhe të dhëna të tjera si, rezultatet e zgjedhjeve, të dhëna të KQZ, qëndrime zyrtare të subjekteve politike.

Sasia e të dhënave të marra nga raportet varion në funksion të fokusit, qëllimit dhe metodologjisë që kanë përdorur nga OSHC-të që i kanë nxjerrë raportet. Për pasojë, raporte të ndryshme mbulonin pjesë të ndryshme të procesit dhe kështu kanë siguruar të dhëna për atë pjesë që kanë patur në fokus (Grafik 3).




*Grafik 3: Raportet e përdorura për IIZ dhe të dhënat e marra prej secilit raport*

Të dhënat e grumbulluara nga secili raport ndryshojnë. Megjithatë nuk ka ndonjë raport që të ketë qenë dominant përse i përket të dhënave dhe nga disa raporte janë marrë të dhëna më të shumta se në disa të tjerë. Kështu në 6 raporte janë mbledhur rreth gjysma e të dhënave të përdorura në llogaritjen e indeksit.

Meqënëse raportet e prodhuara nga OSHC-të nuk kanë qenë të parashikuara që të mbulonin të gjithë treguesit dhe nëntreguesit e IIZ sasia e të dhënave

të marra për çdo indikator varion (Grafik 3). Për disa indikatorë, si Kufijtë e Zonave Zgjedhore, Pas Zgjedhjeve apo Ligjet Zgjedhore, raportet kanë patur më pak të dhëna. Ndërsa për indikatorë të tjerë si, Financat e Fushatës, Mbulimi i Fushatës nga Media apo Procesi i Votimit, sasi e të dhënave në raporte ka qenë më e madhe.

Megjithatë, edhe pse ndryshimet në sasinë e të dhënave mund të kenë ndikuar pjesërisht në vlerësimin e secilit indikator apo të dhënat nuk kanë lejuar mundësinë për të bërë vlerësime më të detajuara në disa aspekte, në tërësi të dhënat kanë bërë të mundur hartimin e këtij indeksi.



Grafik 4: Të dhënat e gjetura në raporte sipas indikatorëve

### 3. Përpunimi i të dhënave dhe përlllogaritja e Indeksit

IIZ u llogarit duke krijuar fillimisht një bazë të dhënash të krijuar nga raportet e prodhuara nga OSHC-të. Për krijimin e kësaj baze të dhënash, fillimisht, brenda secilit raport u klasifikuan të dhënat sipas indikatorëve të përzgjedhur, pra të dhënat për ligjet zgjedhore, procedurat zgjedhore, regjistrimi i partive politike, kufijtë e zonave zgjedhore, regjistrimi i votuesve, regjistrimi i partive politike, mbulimi i fushatës nga media, financat e fushatës, procesi i

votimit, numërimi i votave ,pas zgjedhjeve dhe numërimi i votave.

Për të vlerësuar indikatorët sipas të dhënave u përdor matja me shkallë nga 1 në 4, për secilin prej 47 treguesve të performancës si dhe për 102 nëntreguesit. Vlerësimi me 1 pikë i referohet shkallës më të ulët të performancës së treguesit, nëntreguesit apo indikatorit, ndërkohë që vlerësimi me 4 pikë i referohet shkallës më të lartë të performancës së indikatorit.

Performanca u mat në bazë të vlerësimeve si më poshtë:

Nr.	Statusi	Përshkrimi	Vlerësimi për treguesin
1	Në asnjë rast	Vlerësimi për treguesin është që në asnjë rast nuk është zbatuar standardi	1
2	Në disa raste	Vlerësimi për treguesin është që në disa raste është zbatuar standardi.	2
3	Në shumicën e rasteve	Vlerësimi për treguesin është që në shumicën e rasteve është zbatuar standardi	3
4	Në të gjitha rastet	Vlerësimi për treguesin është që në të gjitha rastet është zbatuar standardi	4

*Tabela 1. Mënyra e vlerësimit të të dhënave për përlllogaritjen e indikatorëve*

Për të llogaritur vlerën e indeksit për secilin nga indikatorët në fillim u krye llogaritja e nëntreguesve, më pas llogaritja e treguesve dhe kjo ka shpënë në llogaritjen e indikatorit.

Të gjithë nëntreguesit brenda çdo treguesi janë caktuar mesatarisht që të krijojnë një rezultat të treguesit. Të gjithë nëntreguesve iu është dhënë vlera e njëjtë brenda një treguesi, dhe po kështu edhe treguesve i është dhënë vlerë e njëjtë brenda indikatorit.

Llogaritjet bazohet mesatarizimin e çdo treguesi dhe nëntreguesi. Kjo, nga koncepti i mesatareve, peshon treguesit dhe nëntreguesit në mënyrë të njëjtë. Gjithashtu, të dhënat e mbledhura janë konsideruar homogjene pavarësisht sasisë së të dhënave të mbledhura për tregues apo nëntregues.



Rezultatet e marra për secilin nëntregues shërbyen për të përlllogaritur dhe vlerësuar secilin prej treguesve të performancës, rezultate të cilat më pas janë përlllogaritur për të dhënë vlerësimin për secilin indikator (Shtojca 2).

#### **4. Avantazhet dhe Kufizimet e IIZ**

Qëllimi i këtij indeksi është që të ofrojë një kuadër për vlerësimin e cilësisë së zgjedhjeve, i cili do të jetë në gjendje të nxjerrë në pah arritjet dhe fushat e dobëta të administrimit të zgjedhjeve.

Vlerësimi i zgjedhjeve nëpërmjet indikatorëve të numerizuar do të bëjë të mundur që në të ardhmen të kemi tregues të matshëm dhe të krahasueshëm për të vlerësuar ecurinë e cilësisë dhe integritetit të zgjedhjeve.

Kështu, IIZ mund të ndihmojë që në të ardhmen përpjekjet të mund të përqëndrohen për përmirësimin e indikatorëve që kanë patur rezultate më të dobëta, ndërkohë që synohet konsolidimi i atyre të suksesshëm. Rezultatet e matura të indikatorëve mund të përdoren nga politikëbërësit, zyrtarët e zgjedhjeve dhe të tjerë aktorë për tu fokusuar dhe adresuar në mënyrë specifike gjithashtu çështje të cilat janë identifikuar edhe në indikatorët e performancës apo nën indikatorët.

IIZ është një përpjekje për të kthyer të dhënat cilësore, opinionet dhe vlerësimet e organizatave në tregues të matshëm. Duke qenë të matshëm, treguesit janë më mirë të kuptueshëm dhe të interpretueshëm edhe nga publiku më i gjerë pasi vetëm nga leximi i rezultateve të indikatorëve mund të reflektohet mbi fushat ku procesi zgjedhor është zhvilluar sipas standardeve apo fushat ku problematika ka qenë prezente.

Megjithatë, megjithë avantazhet e parashtruara më sipër ky indeks ka edhe kufizimet e veta. Ndryshimet në sasinë e të dhënave për secilin indikator dhe mbledhja e të dhënave për hartimin e raporteve nga OSHC-të pa iu referuar IIZ përbën dhe një nga kufizimet kryesore të këtij indeksi. Kjo pasi hartimi i IIZ ka filluar mbasi OSHC-të kishin filluar punën për hartimin e raporteve të tyre dhe studimi nuk pati mundësi të hartonte pyetjet dhe të mblidhte të dhënat sipas rubrikave apo pyetjeve të shtruara në metodologji. Po kështu, të dhënat cilësore të përdorura japin informacion në formë përshkruese, dhe përfshijnë opinionet, komente apo dhe analiza cilësore për aspekte të caktuara por pa treguar se mbështeten në të dhëna solide.

Disa herë ka patur analiza thelbësore të mbështetura në të dhëna dhe fakte të qenësishme dhe të verifikuara dhe në raste të tjera të dhënat janë sipërfaqësore. Vetëm pjesërisht ka patur raporte të nxjerra mbi të dhëna nga anketime statistikore apo në metoda solide shkencore. Në disa raste, kur jepet një opinion apo e dhënë, nuk del qartë rruga për të arritur në këtë konkluzion, ç'ka e vështirëson racionalizimin e fenomenit dhe vlerësimin e opinionit.

Por, përveç se bën një vlerësim të zgjedhjeve vendore të 21 qershorit 2015 synimi i IIZ është që e njëjta qasje dhe metodologji të përdoret edhe për zgjedhjet e ardhshme, ndërkohë që synohet të përmirësohet mbledhja e të dhënave dhe të arrihet një shkallë më e lartë konvergjence metodologjike e raporteve që do të përdoren.

## II. INDEKSI I INTEGRITETIT TË ZGJEDHJEVE

### 1. Ligjet Zgjedhore

Konkurrimi në zgjedhje demokratike synon të përmbushë disa objektiva ku ndër më të rëndësishmet janë formimi i institucioneve të cilat përfaqësojnë sa më drejtë vullnetin e votuesve. Duke qenë se nëpërmjet zgjedhjeve aktorët politikë synojnë të marrin pushtetin dhe ndikojnë në hartimin e politikave publike dhe menaxhimin e resurseve shtetërore, proceset zgjedhore duhet të garantojnë që konkurrimi të jetë sa më i drejtë dhe i paanshëm. Një nga hapat e parë për të realizuar këtë është hartimi i ligjeve zgjedhore të qarta dhe të plota.

Për të vlerësuar këtë indikator, u përcaktuan disa tregues të cilët mundësojnë matjen e tij, siç janë: Shkalla e pranimit të legjislacioni zgjedhor nga të gjitha subjektet e përfshira në zgjedhje; Niveli i besimit për legjislacionin nga shumica e subjekteve të përfshira në zgjedhje; Diskriminimi ose jo në legjislacion për regjistrimin e partive politike dhe/ose kandidatëve; Kufizimi në legjislacion i hapësirës së subjekteve politike për koalicione parazgjedhore; Plotësimi në legjislacion i standardeve ndërkombëtare dhe sigurimi në mënyrë adekuate i respektimit të të drejtave themelore të njeriut;

Kuptueshmëria e kuadrit ligjor.

### **Vlerësimi për indikatorin mbi Ligjet Zgjedhore është 2.29.**

*Legjislacioni zgjedhor është i paplotë dhe jo tërësisht i qartë çka lejon aktorët e angazhuar në administrimin e procesit zgjedhor të marrin vendime të njëanshme dhe diskrecionale. Legjislacioni zgjedhor nuk është i pranuar gjerësisht dhe pjesëmarrja në miratimin e tij është e pjesshme. Mosharmonizimi i legjislacionit dhe kufizime të parashikuara në kodin zgjedhor kanë çuar në deformimin e konkurrencës dhe me pasoja veçanërisht për kandidatët e pavarur.*

Janë një sërë problemesh të identifikuara në këto raporte si mungesa e konsensusit ndërmjet aktorëve politikë për të realizuar përmirësime të kuadrit ligjor, i cili mbetet i paplotë.<sup>2</sup> Kuadri aktual ligjor nuk ofron kushte të barabarta për të gjithë garuesit e zgjedhjeve. Partitë politike, pa vende në koalicionet e mëdha të Kuvendit dhe/ose jashtë koalicioneve, si dhe kandidatët e pavarur, duhet të mbledhin një numër të konsiderueshëm firmash mbështetëse (jo më pak se 1% të votuesve në një ZAZ të caktuar), ndërsa koalicionet e mëdha dhe partitë që kanë poste në Kuvend, ose kandidatët e pavarur që mbajnë poste të larta zyrtare, janë të përjashtuar nga ky rregull.<sup>3</sup>

Ky problem u bë më i theksuar me ndarjen e re administrativo-territoriale dhe rritjen e madhësisë së njësive administrative pasi përmbushja e kërkesave nga kandidatët e pavarur u vështirësua dhe për pasojë konkurrimi ndërmjet subjekteve nuk ishte i barabartë.<sup>4</sup>

Përveç kësaj, kandidatët e pavarur dhe partitë që konkurrojnë për herë të parë nuk janë të lejuar për të përfituar nga fondet publike për të kryer fushatën e tyre. Neni 87 i Kodit Zgjedhor përcakton se “Partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, të cilat kanë marrë jo më pak se 0.5 për qind të votave në mbarë vendin, kanë të drejtë të përdorin fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave të secilës parti në këto zgjedhje”.<sup>5</sup>

Një pasojë e drejtpërdrejtë është njëanshmëria dhe diskrecioni nga ana e administratës zgjedhore në zbatimin e ligjit zgjedhor. Janë disa vendime

2 “Raport i ndërmjetëm monitorimi I, 10 Janar-26 Mars 2015”, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

3 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri”, Raporti Përfundimtar, KZLN

4 “Përmbledhje e raportit përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015”, Dhoma Zgjedhore

5 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri”, Raporti Përfundimtar, KZLN

të institucioneve të administrimit të zgjedhjeve, të cilat tregojnë se këto institucione zbatojnë standarde të paqarta në vendimet që marrin.

Kështu Vendimi i KQZ nr. 88 datë 7 Prill 2015 “Për miratimin e modeleve të kandidimit që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor”, krijoi më shumë çoroditje duke qenë se ndryshe u votua dhe ndryshe u zbardh përmbajtja e këtij vendimi. Po kështu Kolegji Zgjedhor mori një vendim i cili e shtoi konfuzionin e krijuar pasi e rrëzoi vendimmarrjen e KQZ referuar vendimit nr. 88 datë 7 Prill 2015, por pa e shfuqizuar këtë vendim. Kjo situatë reflektoi akoma më shumë paqartësi për standardin që KQZ do të përdorte në vazhdim.<sup>6</sup>

Paqartësia, diskrecioni dhe njëanshmëria në zbatimin e kodit zgjedhor u pa edhe në marrjen e “Vendimit të KQZ Nr. 13, datë 27.01.2015” nëpërmjet të cilit KQZ i atribuon vetes të drejtën e çregjistrimit të kandidaturave për Kryetar Bashkie duke marrë një kompetencë e cila nuk i jepet nga ligji zgjedhor.<sup>7</sup>

## 2. Procedurat Zgjedhore

Procedurat zgjedhore përfshijnë të gjithë aktorët si ata vendimmarrës, influencues apo të influencuarit nga procesi. Për shkak të rëndësisë së procedurave në proceset zgjedhore vlerësimi i tyre përbën një nga indikatorët kryesorë për vlerësimin e cilësisë së zgjedhjeve. Për të vlerësuar këtë indikator mbështetur në raportet e organizatave të shoqërisë civile u përcaktuan treguesit e performancës në vijim: Menaxhimi i zgjedhjeve; Lehtësirat në sigurimin e informacionit mbi procedurat e votimit; Vendimmarrja e administratës zgjedhore; Shkalla e zbatueshmërisë së ligjit.

### **Vlerësimi për indikatorin Procedurat Zgjedhore është 2.45.**

*Zgjedhjet u menaxhuan relativisht mirë nga KQZ, por probleme të shumta u shfaqën me administratën zgjedhore në nivelet më të ulta. KQZ organizoi trajnimet e duhura për nivelet më të ulta të administratës zgjedhore dhe përmirësoi punën për informimin e zgjedhësve, përfshirë të rinjtë që votuan për herë të parë dhe minoritet. Megjithatë ndryshimet e shpeshta të përbërjes së komisioneve në nivelet më të ulta të administratës zgjedhore e dëmjuan respektimin e procedurave dhe cilësinë e zgjedhjeve në përgjithësi.*

<sup>6</sup> “Raport i ndërmjetëm monitorimi II, 27 Mars-21 Maj 2015”, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

<sup>7</sup> “Raport i ndërmjetëm monitorimi III, 22 Maj-18 Qershor 2015”, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Raportet e analizuara tregojnë se KQZ bëri përpjekjet e duhura për të mirë administruar procesin zgjedhor. KQZ kontribuoi në nxjerrjen e udhëzimeve dhe miratimin a akteve në zbatim të legjislacionit zgjedhor,<sup>8</sup> në trajnimin e administratës zgjedhore të niveleve më të ulta dhe mori masat e duhura për të informuar votuesit që votuan për herë të parë si dhe votuesit e rinj në përgjithësi.<sup>9</sup> Po kështu KQZ mori masa dhe realizoi aktivitete për informimin e pakicave kombëtare.<sup>10</sup>

Por vonesat në emërimin e zyrtarëve zgjedhorë në nivele më të ulta e dëmtuan procesin a informimit dhe edukimit të votuesve për shkak të vonesave në krijimin e Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe ndryshimet e shpeshta. Emërimi më i hershëm dhe qëndrueshmëria e tyre do të siguronte që zyrtarët zgjedhorë të identifikoheshin me procesin zgjedhor në komunitetet ku jetojnë dhe të shërbenin si burime informacioni për votuesit respektivë.

Për më tepër ndryshimet e shpeshta të komisionerëve e përkeqësuan këtë aspekt të administrimit të zgjedhjeve pasi zëvendësuesve shpesh u mungoi formimi dhe eksperiencia e duhur. Emërimi i anëtarëve të KZAZ-ve rezultoi veçanërisht problematik pasi jo vetëm që nuk u realizua brenda afatit 13 prill 2015, por ndryshimet në përbërjen e KZAZ vazhduan edhe gjatë periudhës së fundit parazgjedhore Maj – Qershor 2015.<sup>11</sup> Deri në ditën e zgjedhjeve, pati 272 zëvendësime komisionerësh dhe 48 prej tyre u zëvendësuan pasi ishin trajnuar nga KQZ-ja.<sup>12</sup>

Pasoja të drejtpërdrejta të këtij problemi si dhe moszbatimit me korrektësi të procedurave zgjedhore dhe mungesës së trajnimit të vazhdueshëm ishin problemet që u vërejtën në hapjen e qendrave të votimit, gjatë procesit të votimit si dhe gjatë mbylljes së procesit.<sup>13</sup>

Njëkohësisht puna e autoriteteve zgjedhore u ndikua shumë nga vullneti i partive politike.<sup>14</sup> Një tjetër karakteristikë e punës së autoriteteve zgjedhore në të gjitha nivelet, ka qenë mungesa e transparencës të konsiderueshme, pasi ato nuk arritën të informojnë plotësisht dhe në kohën e duhur publikun rreth mbledhjeve dhe rezultateve të punës së tyre.<sup>15</sup>

8 Raporti i gjetjeve kryesore të zgjedhjeve lokale 21 qershor 2015, KShH

9 “Raport vlerësimi i situatës parazgjedhore, Nëntor 2013- 9 Janar 2015” KVV

10 “Raport i ndërmjetëm monitorimi III, 22 Maj-18 Qershor 2015”, KVV

11 Raport i ndërmjetëm “ Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

12 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar”, KZLN

13 Raporti i gjetjeve kryesore të zgjedhjeve lokale 21 qershor 2015, KShH

14 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar”, KZLN

15 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar”, KZLN

### 3. Kufijtë e Zonave Zgjedhore

Kufijtë e zonave zgjedhore dhe përcaktimi i tyre janë të rëndësishme për cilësinë e zgjedhjeve pasi ato mund të ndikojnë në rezultatin zgjedhor dhe për pasojë në proceset politike dhe legjitimitetin e institucionet që dalin prej tyre.

Përdorimi i kompetencave ligjore nga shumica në legjislativ dhe ekzekutiv për të ndikuar në përcaktimin e zonave zgjedhore me qëllim devijimin e rezultat është evidentuar në zgjedhje të mëparshme në Shqipëri.

Edhe në këto zgjedhje pati kundërshtime nga subjektet politike që buronin nga preokupimi se përcaktimi i numrit të njësive administrative dhe shpërndarja e tyre kishin prapavije elektorale dhe u ndikuan nga shkalla e mbështetjes që parti të ndryshme kanë në pjesë të ndryshme të vendit.

Një nga pasojat negative të mosbesimit ndaj procesit të reformës administrative ishte edhe përshkallëzimi i polarizimit dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet partive kundërshtare, veçanërisht në periudhën parazgjedhore. Një tjetër pasojë me ndikim negativ për procesin politik ishte se partitë nuk i informuan votuesit e tyre për efektet e reformës për komunitetet e tyre.<sup>16</sup>

Përkundrajt këtij konteksti kufijtë e zonave zgjedhore përbëjnë një nga indikatorët kryesorë për të vlerësuar cilësinë e këtyre zgjedhjeve. Treguesit e performancës për këtë indikator janë: Kufijtë nuk kanë diskriminuar partitë politike; Kufijtë nuk kanë favorizuar të zgjedhurit në detyrë; Kufijtë kanë qenë të paanshëm.

#### **Vlerësimi për indikatorin Kufijtë e Zonave Zgjedhore është 2.13.**

*Megjithëse raportet e nxjerra nga OSHC-të nuk e kanë trajtuar gjerësisht këtë indikator aspekte negative të evidentuara si mosbesimi i partive politike në drejtësinë e procesit të ndarjes administrative dhe mospranimi gjerësisht i procesit, krijimi i perceptimit se kufijtë kanë deformuar përfaqësimin, vështirësitë e krijuara për të planifikuar fushatën elektorale në mënyrë që të reflektoheshin plotësisht ndryshimet e krijuara prej reformës territoriale*

<sup>16</sup> “Përmbledhje e raportit përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015”, Dhoma Zgjedhore, KSHH

*administrative dhe mungesa e komunikimit të hollësishëm me zgjedhësit për efektet e saj nga subjektet politike konkurruese, ndikimi negativ në regjistrimin dhe zhvillimin e fushatës për partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur, përbëjnë disa nga treguesit kryesorë të cilët kanë ndikuar negativisht në cilësinë e këtyre zgjedhjeve.*

#### **4. Regjistrimi i Votuesve**

E drejta e të gjithë qytetarëve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në institucionet qeverisëse të vendit nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është themeli i demokracisë. Pjesëmarrja në votime garantohet nga legjislacioni zgjedhor, i cili përcakton modalitetet për regjistrimin e votuesve dhe krijimin e një regjistri të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës të zgjedhësve, i njohur si listat e votuesve.

Regjistrimi i votuesve dhe listat e zgjedhësve kanë qenë problematike pothuajse në të gjitha zgjedhjet e mëparshme pasi janë konsideruar nga partitë politike dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare si ndër elementët më lehtësisht të manipulueshëm dhe që shpesh janë përdorur për të manipuluar rezultatet zgjedhore.

Për të llogaritur vlerën e indikatorit janë analizuar të dhënat nëpërmjet treguesve të tillë si: Qytetarë nuk kanë qenë të listuar në regjistër; Regjistri zgjedhor ka qenë i saktë; Nuk janë regjistruar zgjedhës të papërshtatshëm, të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore. Nën indikatorët u fokusuan tek informimi i zgjedhësve dhe aksesit në lista, si dhe kuadri për ankimin dhe apelimin.

#### **Vlerësimi për indikatorin mbi Regjistrimin e Votuesve është 2.57**

*Regjistri zgjedhor ka nevojë të përmirësohet ndjeshëm, pasi listat e votuesve kanë patur parregullsi të vazhdueshme. Gjithashtu ka patur probleme me informimin e zgjedhësve mbi listat. Jo të gjithë votuesit janë njoftuar paraprakisht se ku ishin caktuar për të votuar. Në këtë mënyrë është i vështirë verifikimi i saktësisë së Listës së Votuesve për të llogaritur shifrat reale të pjesëmarrjes së qytetarëve në votime.*

Më shumë se 25% e qendrave të votimit në të gjithë vendin patën votues të

cilët nuk e gjetën emrin e tyre në listat e votuesve.<sup>17</sup> Ky fenomen u pasqyrua në bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës.<sup>18</sup>

Në përgjithësi votuesit nuk u njoftuan nga autoritetet vendore përkatëse për shkak të kufizimeve buxhetore dhe delegimit të përgjegjësive midis autoriteteve vendore dhe atyre qendrore. Kjo mund të jetë arsyeja kryesore pse votuesit nuk i gjetën emrat në listat e votuesve.<sup>19</sup>

Ministria e Punëve të Brendshme dhe NJQV-të kanë edhe detyrimin ligjor të njoftimit me shkrim të çdo zgjedhësi që banon në territorin e NJQV-ve, në periudhën nga data 14 Janar deri më datën 15 Mars 2015.<sup>20</sup> Për këtë Ministria e Punëve të Brendshme ka dhe fonde monetare, por këto fonde nuk u vunë në dispozicion sipas përcaktimeve ligjore.<sup>21</sup> Vetëm në pak raste ka të dhëna që zgjedhësit të jenë informuar mbi listën e zgjedhësve në bashki të tilla si Lushnje, Berat, Korçë.

Moskryerja e informimit ka çuar në rënie të interesit për procesin zgjedhor dhe nënvlerësim për pjesëmarrjen në to.”<sup>22</sup>

## 5. Regjistrimi i Partive Politike

Për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të kërkuar përfaqësimin politik nëpërmjet legjitimitit në zgjedhje, partitë politike dhe kandidatët duhet të regjistrohen në institucionet e administrimit të zgjedhjeve dhe të konkurrojnë lirshëm.

Regjistrimi i partive politike dhe kandidatëve kryhet në bazë të rregullave të përcaktuara në ligj dhe këto rregulla duhet të zbatohen në mënyrë të tillë që të mos diskriminojnë ose krijojnë avantazhe të padrejta për parti politike, grupe të ndryshme shoqërore ose kandidatë të caktuar.

Nëse parti politike apo kandidatë besojnë se rregullat zgjedhore janë favorizuese për disa dhe diskriminuese për të tjerë, apo zbatohen në mënyrë të tillë, atëherë kjo ka gjasa që të dëmtojë cilësinë e zgjedhjeve dhe

17 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar”, KZLN

18 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar”, KZLN

19 “Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar”, KZLN

20 “Raport i ndërmjetëm monitorimi I 10 Janar-26 Mars 2015” KVV

21 Gjetjet kryesore të vëzhgimit të procesit përgatitor për zgjedhjet vendore të 21 Qershorit, 2015; 4 Qershor, 2015, KSHH

22 Gjetjet kryesore të vëzhgimit të procesit përgatitor për zgjedhjet vendore të 21 Qershorit, 2015; 4 Qershor, 2015, KSHH



legjitimitetin e institucioneve të dala prej tyre.

Për të vlerësuar indikatorin regjistrimi i partive u përdorën treguesit në vijim: Kandidatët të opozitës nuk janë ndaluar nga konkurrimi në zgjedhje; Gratë kanë patur mundësi të barabarta për të konkurruar; Pakicat etnike dhe kombëtare kanë patur mundësi të barabarta për të konkurruar; Vetëm liderët e partive kryesore zgjedhin kandidatët.

### **Vlerësimi për indikatorin mbi Regjistrimin e Partive Politike është 2.09.**

*Problemet e identifikuar në lidhje me regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve lidhen me mosrespektimin e afateve kohore të regjistrimit, fillimin e fushatës zgjedhore përpara regjistrimit të partive politike dhe kandidatëve, për zgjedhjen e kandidatëve nëpërmjet anashkalimit të procedurave dhe rregullave statutores të partive politike, moszbatimin e kuotave gjinore, vështirësi procedurale të krijuara nga vendime të marra nga KQZ.*

Nga treguesit e analizuar, rezulton se në këto zgjedhje ka patur zbatim selektiv të ligjit në lidhje me regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve, disa herë në rastet e interpretimit të ligjit në mënyrë të ndryshme nga KQZ apo Kolegji Zgjedhor. Përpos kësaj, shumë kandidatë të partive të vogla janë penalizuar për shkak të vendimmarrjes së KQZ. Kjo situatë ka sjellë konfuzion tek kandidatët dhe dokumentacioni që ata duhet të plotësonin për regjistrim. Vendimmarrja e gabuar e KQZ disa herë penalizoi në radhë të parë kandidatët e partive të vogla që u regjistruan për të garuar jashtë koalicioneve apo që do të dëshironin të garonin si të pavarur.<sup>23</sup>

Janë identifikuar probleme edhe me zbatimin e ligjit nga institucionet e administrimit zgjedhor: Kolegji Zgjedhor, KQZ apo KZAZ. Vendimi i KQZ Nr. 88 datë 07.04.2015 i hoqi të drejtën partive që zotëronin mandate në këshillat e komunave apo si kryetar komune të futeshin në garë pa mbledhur nënshkrimet e 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore. Kolegji Zgjedhor e rrëzoi vendimmarrjen e KQZ-së, por pa e shfuqizuar këtë vendim. Kjo situatë solli konfuzion tek kandidatët dhe dokumentacioni që ata duhet të plotësonin për regjistrim. Për më tepër që pas rrëzimit të këtij vendimi, tashmë u soll si argument kalimi i afatit të regjistrimit të kandidatëve në KQZ apo KZAZ-në përkatëse. Vendimmarrja e gabuar e KQZ dhe gjithë

23 "Raport i ndërmjetëm monitorimi II, 27 Mars-21 Maj 2015", KVV

kjo situatë penalizoi në radhë të parë kandidatët e partive të vogla që u regjistruan për të garuar jashtë koalicioneve apo që do të dëshironin të garonin si të pavarur.<sup>24</sup>

Respektimi i afateve të regjistrimit nga partitë politike dhe kandidatët rezultoi me probleme. Raportet e vëzhgimit kanë konstatuar shkelje të afatit të fillimit të fushatës duke shkelur afatet që përcakton ligji. Të dyja koalicionet politike, kanë prezantuar kandidatët e tyre së paku një muaj përpara datës zyrtare në të cilën duhej të niste fushata zgjedhore.<sup>25</sup> Në bazë të Kodit Elektorale fushata zgjedhore pavarësisht se duhet të fillonte më 22 maj 2015, u vu re që PS, PD dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) e shkelën këtë kërkesë, pasi e filluan fushatën përpara datës së caktuar, duke zhvilluar ture elektorale të liderëve të partive në qytetet kryesore.<sup>26</sup>

Edhe procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për kryetar bashkie, në pjesën më të madhe është vlerësuar si jo transparent dhe jo në përputhje me normat statutoare të partive politike. “Në shumicën e rasteve kandidatët janë përzgjedhur direkt prej kryetarëve të partive, apo janë përzgjedhur si pasojë e marrëveshjeve mes kryetarëve të dy apo më shumë partive të të njëjtit koalicion”.<sup>27</sup>

Përfshirja e minoriteteve ka qenë më pak problematike dhe evidentohet fakti se nuk ka patur grupe apo minoritete të cilat të jenë diskriminuar apo penguar të marrin pjesë në zgjedhje. Në Strategjinë për Edukimin Zgjedhor të Shtetasve miratuar dhe zbatuar nga KQZ-ja parashikohet ndërmarrja e hapave konkretë për informimin dhe sensibilizimin e veçantë të disa grupimeve të përcaktuara shoqërore, përfshirë këtu edhe minoritetet etnike dhe etnokulturore, në lidhje me të cilët strategjia përcakton informimin dhe pajisjen me informacionin e nevojshëm zgjedhor në gjuhët respektive.<sup>28</sup>

Gratë gjithashtu kanë patur mundësi më të larta për të konkurruar në këto zgjedhje. Përmirësimi i kuotave gjinore është evidentuar në shumë raporte.

24 “Raport i ndërmjetëm monitorimi II, 27 Mars-21 Maj 2015”, KVV

25 “Raport i ndërmjetëm monitorimi II, 27 Mars-21 Maj 2015”, KVV

26 “Raport i ndërmjetëm “ Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

27 “Përmbledhje e raportit përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015”, Dhoma Zgjedhore

28 “Raport vlerësimi i situatës parazgjedhore, Nëntor 2013- 9 Janar 2015”, KVV

## 6. Mbulimi i Fushatës nga Media

Media ka një rol të rëndësishëm në zgjedhje pasi informacionet dhe mesazhet e komunikuara nga media ndikojnë fuqishëm në formatimin e opinionit publik dhe formësimin e preferencave të votuesve për partitë politike dhe kandidatët.

Për këtë arsye media duhet të jetë e lirë dhe e pa ndikuar nga parti politike, kandidatë apo grupe të ndryshme interesi të cilët mund të synojnë promovimin e axhendave të tyre apo pengimin e konkurrentëve nëpërmjet formave të ndryshme të manipulimit mediatik.

Për të matur indikatorin mbulimi i fushatës nga media u përdorën treguesit në vijim: Gazetat kanë dhënë lajme të balancuara elektorale; Lajmet televizive nuk kanë favorizuar partinë qeverisëse; Partitë/kandidatët kanë patur akses të drejtë në transmetimet dhe reklamat politike; Gazetarët kanë siguruar mbulim të drejtë të zgjedhjeve; Media sociale është përdorur për të transmetuar mashtrimet elektorale. Po kështu janë përdorur dhe një sërë nëntreguesish si: Kandidatët e partive të mëdha janë favorizuar më shumë krahasuar me ata të partive më të vogla; Kandidatët e pavarur janë trajtuar si të barabartë në mbulimin mediatik të fushatës; Kandidatët ose partitë politike janë trajtuar në mënyrë të barabartë nga media publike; Informimi i publikut për kandidatët/partitë ka qenë i mjaftueshëm, objektiv dhe i balancuar; Janë zbatuar dispozitat ligjore që përcaktojnë pjesëmarrjen e partive/kandidatëve në transmetimet dhe reklamat politike; Nuk janë evidentuar shkelje lidhur me kohën dhe përmbajtjen që partitë/kandidatët kanë bërë gjatë prezantimeve të tyre elektorale në media; Mediat nuk kanë shpifur ose shtrembëruar mesazhet e kandidatit; Bordi i Monitorimit të Mediave ka qenë i paanshëm dhe profesional; Kanë ekzistuar platforma të veçanta sociale për të grumbulluar informacione mbi fushatën elektorale; Platformat apo mediat sociale kanë qenë të suksesshme dhe efektive dhe kanë patur ndikim tek votuesit.

**Vlerësimi për indikatorin Mbulimi i Fushatës nga Media është 2.67.**

*Mediat shfaqën një shkallë të lartë të ndikimit nga partitë politike dhe grupet e interesit duke mos arritur të japin një mbulim të pavarur dhe*

*të balancuar. Mbulimi mediatik i fushatës është ndikuar më së shumti nga shkalla e ndikimit politik dhe mjeteve financiare të konkurrentëve se sa nga parimi i informimit të publikut. Një nga mangësitë kryesore ishte përcimi nga mediat e shkruara dhe televizive i lajmeve të prodhuara nga vetë partitë politike apo kandidatët në formën e transmetimeve të gatshme apo nëpërmjet marrjes së të dhënave nga rrjetet sociale por pa verifikuar vërtetësinë e tyre. Përcaktimi i axhendës së mediave nga partitë politike dhe grupe të fuqishme të interesit u vërejt në fokusin pothuajse ekskluziv tek kandidatët për kryetarë bashkie duke lënë pothuajse të paraportuar informacione mbi kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiake, si dhe në mungesën e hapësirës së mjaftueshme mediatike për kandidatët e pavarur.*

Përsa i përket shkallës së informimit në mënyrë objektive dhe të balancuar nga ana e medias për kandidatët dhe partitë politike vlerësohet se media e ka kryer pjesërisht këtë rol. Një nga problemet kryesore të evidentuara është praktika e transmetimit të takimeve elektorale nga televizionet, të cilat përdorin sinjalin e prodhuar nga vetë shtabet elektorale me anë të regjisë qendrore apo kasetat informative të përgatitura po prej tyre me zë dhe figurë.<sup>29</sup> Televizionet i transmetojnë produktet mediatike të përgatitura nga subjektet politike pa verifikuar apo analizuar të dhënat apo mesazhet e transmetuara duke kryer thjesht rolin e përcuesit.

Një dobësi tjetër e mbulimit mediatik të fushatës dhe e ndikimit të partive politike në përcaktimin e axhendës së mediave ishte përqendrimi tek kandidatët për kryetarë bashkie që garuan në zgjedhje. Në shumicën e raporteve konstatohet se fushata elektorale u përqendrua pothuaj tërësisht tek kandidatët për kryetarë të bashkive dhe mungoi informacioni dhe hapësira për kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiake. Për pasojë votuesit nuk patën ose patën fare pak informacion për kandidatët për këshilla bashkiakë si për shembull formimi i tyre, kontributi i tyre shoqëror dhe platformat e tyre elektorale në shërbim të komunitetit.<sup>30</sup>

Po kështu mbulimi nga mediat i fushatës së kandidatëve të pavarur ishte i dobët. Raportet theksojnë se kandidatët e pavarur nuk patën akses të mjaftueshëm në mediat kombëtare duke e bërë fushatën e tyre të pabarabartë me konkurrentët partiakë.<sup>31</sup> Fushatat e kandidatëve të pavarur janë mbuluar në shkallë më të ulët nga media për shkak të kufizimeve të tyre financiare

29 "Raport i ndërmjetëm monitorimi II, 27 Mars-21 Maj 2015", KVV

30 "Raport i ndërmjetëm " Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015" KZLN

31 Raport i ndërmjetëm " Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015" KZLN

dhe strukturore.<sup>32</sup>

Aktiviteti i Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) është një tjetër tregues i rëndësishëm për të vlerësuar indikatorin që lidhet me shkallën e mbulimit të medias për shkak të rolit monitorues. Megjithatë roli i BMM paraqitet i zbehtë dhe institucioni ka mungesa të theksuara të stafit të kualifikuar, pajisjeve dhe metodologjisë së duhur në mënyrë që të monitorojë në mënyrë efektive numrin dhe cilësinë e transmetimeve gjatë zgjedhjeve.

Mbulimit mediatik të fushatës i është shtuar edhe komunikimi nëpërmjet përdorimit të platformave dhe rrjeteve sociale, i cili ka ardhur në rritje si dhe një shtim të preferencës së mediave tradicionale për t'iu referuar këtyre rrjeteve.<sup>33</sup> Rrjetet sociale janë përdorur gjerësisht qoftë nëpërmjet faqeve të menaxhuara nga vetë partitë apo kandidatët në garë, qoftë nga faqet zyrtare në to të mediave.<sup>34</sup>

Megjithatë përveç potencialit pozitive për të komunikuar në mënyrë masive nëpërmjet krijimit të hapësirës për çdo individ, rrjetet sociale përdoren edhe për të komunikuar mesazhe dhe informacione të pavërteta ose pjesërisht të vërteta. Është vërejtur se mediat e shkruara dhe televizive kanë transmetuar shpesh informacione dhe mesazhe të marra nga mediat sociale por pa i verifikuar më parë në mënyrë të pavarur.

## 7. Financat e Fushatës

Financimi i fushatave zgjedhore ka një ndikim të madh cilësinë e zgjedhjeve. Fushatat zgjedhore kanë ardhur duke u bërë gjithnjë e më të kushtueshme dhe fondet shtetërore të parashikuara për partitë politike arrijnë të mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të këtyre fushatave.

Për pasojë partitë politike dhe kandidatët gjithnjë e më tepër po mbështeten në donacione për të ngritur fondet e nevojshme për të realizuar një fushatë efektive apo për të përcjellë mesazhet e tyre tek votuesit.

Kjo qasje mbart rrezikun e financimit të fushatave me burime të dyshimta

32 Raport i dytë ndërmjetëm “Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

33 Raport i dytë ndërmjetëm “Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

34 “Raport i ndërmjetëm monitorimi III, 22 Maj-18 Qershor 2015”, KVV

financimi ose premtimeve nga kandidatët për krijime favoresh donatorëve të ndryshëm nëpërmjet pushtetit të ardhshëm, premtime të cilat realizohen nëpërmjet praktikave korruptive dhe influencës nëpërmjet institucioneve shtetërore.

Për këto arsye çështjet e financimit të fushatave kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në cilësinë e zgjedhjeve pasi përdorimi i fondeve të dyshimta sjell pabarazi në fushatë, mund të deformojë rezultatin zgjedhor dhe për pasojë të sjellë deformimin e përfaqësimit në institucionet e dala nga zgjedhjet.

Nga ana tjetër autoritetet shtetërore dhe qytetarët kanë një interes të ligjshëm për tu siguruar që financimet e fushatës të jenë të ndershme, transparente dhe të kufizojnë mundësinë për korrupsion.

Për të vlerësuar indikatorin mbi financimin e fushatës u përdorën treguesit në vijim: Partitë dhe kandidatët kanë patur akses të njëjtë në subvencionet publike; Partitë dhe kandidatët kanë patur akses të njëjtë në donacionet politike; Partitë dhe kandidatët kanë publikuar dhe bërë transparente llogaritë financiare; Nuk janë përdorur individët e pasur për të “blerë” zgjedhjet; Burimet shtetërore nuk janë përdorur në mënyrë të paligjshme për fushatë.

#### **Vlerësimi për indikatorin Financat e Fushatës është 1.84.**

*Indikatorin mbi financat e fushatës është më i ulët nga të gjithë indikatorët e analizuar. Partitë kanë përdorur financat si mjet për të ndikuar mbi votuesit duke tejkaluar shpenzimet e parashikuara nga buxheti për zgjedhjet. Megjithatë subjektet konkurruese dhe institucionet e ngarkuara me sigurimin e transparencës financiare të zgjedhjeve dështuan në mbledhjen, publikimin dhe vlerësimin e financimit të fushatës. Në shumë raste ka patur përdorim të burimeve shtetërore në funksion të kandidatëve.*

Raportet tregojnë se në këto zgjedhje ka munguar transparenca në lidhje me financimet e fushatës. “Vetëm një kandidat i pavarur ka zbardhur kontributet financiare nga donatorët e tij dhe ka ftuar partitë të veprojnë njësoj”.<sup>35</sup>

Kjo mungesë transparence është shpjeguar duke identifikuar disa shkaqe. Së pari, shkalla e ulët e moszbatimit të ligjit. Më specifikisht, në raporte theksohet se një element tepër formal që parashikon Ligji për Partitë Politike është publikimi i numrit të Llogarisë Bankare të çdo subjekti politik në

<sup>35</sup> Raport i ndërmjetëm “Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në fakt, në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjenden numrat e Llogarive Bankare të vetëm katër subjekteve zgjedhore.<sup>36</sup> Së dyti, mungesa e zbatimit korrekt të ligjit nga vetë organet zgjedhore, pasi KQZ nuk publikoi se cila ishte sasia e fondit e caktuar për secilin subjekt zgjedhor, cilët ishin subjektet që duhet të kthenin diferencën nga fondi paradhënie dhe cilat subjekte përfitonin nga Buxheti i Shtetit sipas rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend të datës 23 Qershor 2013.<sup>37</sup> Së treti, ka mangësi të bazës ligjore për të rregulluar rastet kur zyrtarë të lartë, funksionarë publikë, madje dhe vetë Kryetarët e Partive, kryejnë dhurime financiare për subjektet zgjedhore, raste të cilat nuk gjejnë adresim në Kodin Zgjedhor.<sup>38</sup>

Probleme janë identifikuar edhe me përdorimin e burimeve shtetërore nga subjektet politike konkurruese. Edhe në këto zgjedhje u konstatua përfshirja e administratës publike në fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetar bashkie. Po kështu, përmbushje të detyrimeve ligjore të institucioneve të pushtetit qendror apo lokal u përdorën gjatë fushatës për të ndikuar mbi votuesit.<sup>39</sup> Në të njëjtën mënyrë janë përdorur për qëllime të fushatës në favor të kandidatëve të caktuar ambiente publike si shkollat, portet detare apo ambientet spitalore.<sup>40</sup>

Pozita e kandidatëve dhe partive politike u përdor për të ndikuar tek votuesit punonjës të administratës vendore dhe qendrore duke i detyruar ata të ndiqnin aktivitete zgjedhore gjatë orarit zyrtar të punës dhe duke ushtruar presion për të mos e shprehur vullnetin e tyre të lirë në zgjedhje.<sup>41</sup>

Institucionet dhe burimet shtetërore janë përdorur edhe për të shpërndarë donacione dhe ndihma për familje të përmytura nga subjekte garuese në zgjedhje në disa qytete.<sup>42</sup>

36 “Qëndrim publik i koalicionit të vëzhguesve vendorë mbi transparencën e financimit të partive politike” KVV

37 “Qëndrim publik i koalicionit të vëzhguesve vendorë mbi transparencën e financimit të partive politike” KVV

38 “Qëndrim publik i koalicionit të vëzhguesve vendorë mbi transparencën e financimit të partive politike” KVV

39 “Raport i ndërmjetëm monitorimi IV, 19j-26 Qershor 2015”, KVV

40 “Përmbledhje e raportit përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015”, Dhoma Zgjedhore

41 “Përmbledhje e raportit përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015”, Dhoma Zgjedhore

42 Raport i ndërmjetëm “Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

## 8. Procesi i Votimit

Procesi i votimit shtrihet në një afat të shkurtër kohor, pra vetëm ditën e votimit, por ai mishëron të gjitha përgatitjet e kryera gjatë gjithë procesit elektoral. Mbarëvajtja e procesit të votimit varet nga shkalla e përgatitjes dhe masat e marra, por të gjithë aktorët e përfshirë në procesin zgjedhor kanë rolin e tyre në procesin e votimit. Cilësia e zgjedhjeve gjatë procesit të votimit mund të ndikohet negativisht si rezultat i ndikimit të vullnetit të votuesve nëpërmjet formave të ndryshme si frikësimi, moskrijimi i kushteve të nevojshme për të votuar në mënyrë të fshehtë, aksesit në qendrat e votimit, mosshprehja e vullnetit për shkak të vështirësisë për të kuptuar dhe interpretuar fletën ose fletat e votimit, etj.

Për të vlerësuar indikatorin mbi procesin zgjedhor u analizuan treguesit në vijim: Votuesit nuk janë kërcënuar me dhunë tek qendrat e votimit; Nuk janë hedhur vota të pavlefshme; Procedura e votimit ka qenë e lehtë; Votuesve iu është ofruar një zgjedhje e pandikuar në kutinë e votimit; Lehtësira specifike votimi kanë qenë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara; Shtetasit që jetojnë jashtë vendit mund të votojnë.

### **Vlerësimi për indikatorin Procesi i Votimit është 2.55.**

*Gjatë ditës së zgjedhjeve nuk u evidentuan raste të frikësimit të votuesve për të ndikuar në shprehjen e lirë të vullnetit të tyre. Në përgjithësi votuesit nuk kanë patur vështirësi për të identifikuar qendrën e votimit dhe procedurat e votimit nuk kanë ndikuar negativisht në votim. Probleme ka patur me krijimin e lehtësirave për personat me aftësi të kufizuara ndërsa ashtu si në zgjedhjet e mëparshme votuesit jashtë vendit nuk kanë mundësi votimi në vendet ku banojnë.*

Raportet vlerësojnë procesin e votimit që nga hapja deri në mbyllje si normal, pa ndërprerje dhe të qetë.<sup>43</sup> Megjithatë ka patur disa parregullsi procedurale dhe disa incidente të izoluara, si në rastet e qytetarëve në 22 qendra votimi, të cilëve iu kërkua të largoheshin dhe që nuk iu dha e drejta e votës, pavarësisht se mbanin një vendim gjyqate dhe identifikim

<sup>43</sup> “Raporti i vëzhgimit afatshkurtër të zgjedhjeve vendore, 21 qershor 2015”, Observatori për të drejtat e fëmijëve



të vlefshëm.<sup>44</sup> E kundërta ka ndodhur gjithashtu kur qytetarët nuk kishin as identifikim të vlefshëm dhe as urdhër gjyqate, megjithatë u lejuan të votojnë.<sup>45</sup> Procedurat e timbrimit me bojë u respektuan në 93% të rasteve në mbarë vendin.<sup>46</sup>

Nuk ka patur raste të drejtpërdrejta të frikshmit të votuesve, por janë evidentuar probleme që lidhen me krijimin e rrethanave tensionuese në qendra votimi nga grupime individësh të cilët kanë qëndruar për një kohë të gjatë përpara hyrjeve të këtyre qendrave.<sup>47</sup>

Ka patur raste kur identifikimi i vëzhguesve të forcave të ndryshme politike ka qenë i vështirë për shkak se autorizimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk i kishin vendosur në vende të dukshme. Vëzhguesit e pavarur e kanë patur të vështirë të identifikonin se cili prej personave ishte qytetar i thjeshtë dhe cili prej tyre ishte i akredituar si vëzhgues i forcave politike.<sup>48</sup>

Ka patur vështirësi për të gjetur emrat e tyre në listën e votimit për një numër të madh votuesish, në rreth 25% të qendrave të votimit në tërë vendin.<sup>49</sup>

Personat me aftësi të kufizuar kanë patur vështirësi aksesit në votim pasi qendrat e votimit në tërë vendin nuk kishin parashikuar masa të tilla si dhe kushte për të mundësuar votimin e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të fshehtë.<sup>50</sup> Nga vëzhgimet është konstatuar që 57% e qendrave të votimit në mbarë vendin nuk ishin të aksesueshme për votuesit me aftësi të kufizuara.<sup>51</sup> Administrata vendore dështoi në përpjekjen për heqjen e pengesave për votuesit me kufizime të lëvizshmërisë, duke dështuar rrjedhimisht në sigurimin e zgjedhjeve gjithëpërfshirëse dhe promovimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë në to.<sup>52</sup>

Edhe në mbylljen e procesit të votimit pati parregullsi që lidhen me vonesat në mbylljen e procesit të votimit dhe lejimin e votimit mbas orarit të caktuar.<sup>53</sup>

44 "Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar", KZLN

45 "Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar", KZLN

46 "Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar", KZLN

47 "Raporti i vëzhgimit të ditës së zgjedhjeve", BSSD

48 "Raporti i vëzhgimit të ditës së zgjedhjeve", BSSD

49 "Raport " Monitorimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015, në Shqipëri", KZLN

50 "Raport i ndërmjetëm " Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015", KZLN

51 "Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar", KZLN

52 "Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar", KZLN

53 "Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale të 21 qershorit 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar", KZLN

Përsa i përket votimit të personave që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, këta votues nuk kanë mundur të votojnë në vendet ku jetojnë. Edhe në këto zgjedhje votuesve që jetojnë jashtë vendit u është dashur të vijnë në Shqipëri duke imponuar një kosto shumë të lartë për të ushtruar këtë të drejtë kushtetuese.

## 9. Numërimi i Votave

Numërimi i votave është një nga fazat më të rëndësishme në procesin e zgjedhjeve. Mungesa e transparencës dhe manipulimet në numërimin e votave, vonesat në numërimin e votave dhe publikimin e rezultateve çënojnë cilësinë e zgjedhjeve.

Në zgjedhje të mëparshme në Shqipëri procesi i numërimit të votave ka rezultuar ndër më problematikët dhe efektivisht ka dëmtuar cilësinë e zgjedhjeve dhe është bërë burim krizash të zgjatura institucionale. Forma të manipulimit kanë qenë ndërimi i kutive të votimit, ndryshimi i fletëve të votimit në kuti apo hedhja e votave në to pas mbylljes së votimit, mungesa e transparencës gjatë procesit të numërimit dhe tjetërsimit të votave nga numëruesit, kufizime në dhënien e aksesit vëzhguesve të pavarur, vonesa disaditorëshe në numërim, ç'ka shpinte në pamundësinë e vëzhguesve për të monitoruar këto procese të stërzgjatura, etj.

Për të vlerësuar indikatorin mbi numërimin e votave u analizuan treguesit në vijim: Kutitë e votimit kanë qenë të sigurta; Rezultatet janë publikuar pa vonesa të paligjshme; Votat janë numëruar në mënyrë të drejtë; Vëzhguesit zgjedhorë ndërkombëtarë nuk janë kufizuar; Vëzhguesit zgjedhorë vendas nuk janë kufizuar.

### **Vlerësimi për indikatorin Numërimi i Votave është 2.69.**

*Nga pikëpamja kohore, procesi i numërimit të votave, shënoi përmirësim krahasuar me zgjedhjet e kaluara. Edhe pse vetëm në disa raste, parregullsitë në garantimin e respektimit të procedurave të sigurisë së kutive, ndikimet e jashtme nga njerëz të paautorizuar gjatë procesit të numërimit, mungesa e transparencës dhe krijimi i vështirësive për vëzhguesit e pavarur si dhe vonesat në publikimin e rezultateve bëjnë që numërimi i votave të marrë një vlerësim relativisht të ulët.*

Përsa i përket sigurisë së kutive dhe garantimit është vërejtur se në shumë raste nuk ka patur zbatim rigoroz të procedurave. Komisionerët dhe vëzhguesit nuk morën kopje të kodeve në 16% të qendrave të votimit dhe në 10% të tyre kishte komisionerë, të cilët nuk ishin të pranishëm gjatë hapjes së kutive.<sup>54</sup> Gjatë pranimit në qendrat e numërimit, vetëm 21 kuti votimi u deklaruan të parregullta për shkak të mungesës së kopjeve origjinale të vendimeve të Komisionieve të Qendrave të Votimit (KQV), mungesës së numrave përkatëse serialë ose kodet e sigurisë të dëmtuara në dokumentacionin shoqëruar të fletëve të votimit (KZAZ 71, 74, 2, 26, 39, 43, 68).<sup>55</sup>

Vëzhguesit vendas dhe ndërkombëtarë monitoruan procesin e numërimit të votave dhe në përgjithësi iu siguria akses i mjaftueshëm në qendrat e votimit.<sup>56</sup> Por ka patur raste kur monitoruesit e pavarur janë penguar të vëzhgonin procedurat e hapjes së kutive.<sup>57</sup>

Ndërkohë ka patur probleme me dhënien e aksesit të vëzhguesve gjatë numërimit. Raportet tregojnë se ka patur raste kur vëzhguesit vendorë por edhe vëzhguesit ndërkombëtarë janë nxjerrë jashtë qendrave.<sup>58</sup> Gjatë procesit të numërimit ka patur raste kur janë shkaktuar probleme që kanë çuar në ndërprerjen e procesit të numërimit dhe nxjerrja jashtë e vëzhguesve për të rivendosur rregullin. Në disa prej rasteve është kërkuar edhe ndërhyrja e policisë për të rivendosur qetësinë e nevojshme për të vijuar procesin e numërimit në Vendet e Numërimit të Votave.<sup>59</sup>

Numërimi i votave ka qenë i ngadaltë dhe me zvarritje, pushime të gjata e të tjera problematika. Militantë të partive politike kanë krijuar tensione në mjediset rrethuese të KZAZ dhe në shumë raste vëzhguesit e partive politike komunikojnë me anëtarët e grupeve të numërimit të votave, duke e ngadalësuar akoma më shumë procesin e numërimit.<sup>60</sup>

Përsa i përket publikimit të rezultateve theksohet se pati vonesa në nxjerrjen e rezultateve pas përfundimit të procesit të numërimit. Ky problem është vërejtur në të gjitha bashkitë që kishin më shumë se një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), raste në të cilat është detyrë e KQZ-së që të përpilojë tabelën përmbledhëse dhe të shpallë rezultatin final.

54 Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale të 21 qershorit 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar, KZLN

55 Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar, KZLN

56 Raport mbi gjetjet kryesore të zgjedhjeve lokale 21 qershor 2015, KSHH

57 Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale, 21 Qershor 2015, në Shqipëri, Raporti Përfundimtar, KZLN

58 "Raport i ndërmjetëm monitorimi IV, 19-26 Qershor 2015", Koalicioni i vëzhguesve vendorë

59 "Raport i ndërmjetëm monitorimi IV, 19-26 Qershor 2015", Koalicioni i vëzhguesve vendorë

60 "Raport i ndërmjetëm monitorimi IV, 19-26 Qershor 2015", Koalicioni i vëzhguesve vendorë

## 10. Pas Zgjedhjeve

Zhvillimet post zgjedhore janë kritike për integritetin e gjithë procesit zgjedhor pasi kanë të bëjnë më pranimin e rezultatit nga konkurruesit dhe zhvillimin normal të procesit të formimit të institucioneve të dala nga zgjedhjet. Tradicionalisht zgjedhjet në Shqipëri kanë patur probleme të ndryshme në këtë fazë të procesit dhe kanë ndikuar negativisht në vlerësimin në tërësi të cilësisë dhe integritetit të zgjedhjeve.

Për të vlerësuar indikatorin pas zgjedhjeve u analizuan treguesit në vijim: Partitë dhe kandidatët nuk kanë kundërshtuar rezultatet; Aktivitetet zgjedhore u zhvilluan të qeta; Zgjedhjet nuk shkaktuan protesta të dhunshme; Mosmarrëveshjet janë zgjidhur nëpërmjet mënyrave ligjore.

### **Vlerësimi për indikatorin Pas Zgjedhjeve është 2.17**

*Rezultatet e zgjedhjeve u pranuan gjerësisht, por u evidentua një numër ankesash të paraqitura nga konkurruesit në institucionet e administrimit zgjedhor. Megjithatë ankesat kanë ndjekur rrugën ligjore dhe vendimet e marra janë pranuar. Autoritetet zgjedhore i trajtuan në kohë ankesat por në mënyrë diskrecionale i kanë pezulluar apo zgjidhur ankesat. Mandatet e të zgjedhurve u çertifikuan në kohë dhe nuk pati vonesa në formimin e institucioneve të zgjedhura. Nuk pati protesta të dhunshme apo forma të tjera të manifestimit publik.*

Në KQZ u paraqitën gjithsej 92 kërkesa ankimore pas zgjedhore për të cilat KQZ ka marrë vendime. U bënë 20 ankime pas datës së zgjedhjeve në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ nga palët konkurruese nga të cilat Kolegji Zgjedhor pranoi 9 kërkesa ankimore.

Numri i relativisht i vogël i ankimeve dhe dhënia e shpejtë e vendimeve nuk krijoi pengesa serioze për nxjerrjen e rezultatit përfundimtar dhe çertifikimin e mandateve. KQZ çertifikoi rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në datën 10 Gusht, rreth gjashtë javë nga dita e zgjedhjeve dhe procesi i shpërndarjes së mandateve vijoi normalisht duke mos krijuar pengesa për krijimin e këshillave bashkiake dhe marrjen e detyrës nga kryetarët e rinj të zgjedhur

të bashkive.<sup>61</sup>

Partitë politike kryesore nuk e kundërshtuan rezultatin dhe nuk pati probleme të pranimit të rezultateve. Megjithatë opozita ka shprehur kundërshtitë e saj për zgjedhjet në tërësi duke vënë në dyshim legjitimitetin e zgjedhjeve dhe vetë garantimin e votës së qytetarëve, ç'ka e cënon cilësinë e zgjedhjeve për këtë indikator.<sup>62</sup>

## 11. Autoritetet Zgjedhore

Në menaxhimin e zgjedhjeve përfshihen një sërë hallkash dhe një numër i institucionesh të cilat bëjnë të mundur realizimin e tërë procesit zgjedhor. Autoritetet zgjedhore duhet të jenë sa më të paanshme në mënyrë që të mos ndikojnë në procesin dhe rezultatet e zgjedhjeve, të zbatojnë me përpikmëri dhe efektivitet legjislacionin dhe procedurat zgjedhore si dhe të jenë transparente në mënyrë që veprimtaria dhe performanca e tyre të jenë të monitorueshme dhe të vlerësueshme nga aktorë të tjerë.

Për të vlerësuar indikatorin autoritet zgjedhore, u analizuan treguesit në vijim: Autoritetet zgjedhore kanë qenë jo partiake; Autoritetet zgjedhore kanë shpërndarë informacion tek qytetarët; Autoritetet kanë lejuar diskutime publike mbi performancën e tyre; Autoritetet zgjedhore kanë performuar mirë.

### Vlerësimi për indikatorin Autoritetet Zgjedhore është 1.93.

*Kompozimi i autoriteteve zgjedhore sipas parimit të emërimit nga partitë politike përbën një nga problemet kryesore në Shqipëri. Përkatësia politike e anëtarëve të autoriteteve zgjedhore ka bërë që vendimmarrja e tyre të ndikohet nga konsideratat dhe interesat e partive që përfaqësojnë dhe ka cënuar zbatimin me përpikëri të legjislacionit zgjedhor. Përkatësia politike e anëtarëve të autoriteteve zgjedhore ka bërë që partitë të cilat nuk përfaqësohen në to të shohin me mosbesim paanshmërinë e tyre. Veprimtaria e autoriteteve zgjedhore kanë qenë pjesërisht transparente.*

Veprimtaria e autoriteteve zgjedhore kanë qenë pjesërisht transparente pasi

<sup>61</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, <http://www.cec.org.al/sq-al/Njoftime/deklarata-shtypi>

<sup>62</sup> <http://www.pd.al/2015/09/basha-per-here-te-pare-ne-13-vite-shqiperia-shenohet-si-nje-vend-ku-nuk-garantohet-vota-e-lire-e-qytetareve/>

ka patur raste kur komisionet nuk kanë lejuar vëzhgim të veprimtarisë së tyre dhe raste kur vendimet e marra nuk janë publikuar ose janë publikuar me vonesë. Megjithëse legjislacioni zgjedhor parashikon që mbledhjet e KZAZ janë publike, në shumë raste komisionerët nuk lejuan pjesëmarrjen e personave të tjerë në takime, përfshirë vëzhguesit afatgjatë të KZLNDQ-së, pa paraqitur akreditimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.<sup>63</sup>

Performanca e autoriteteve zgjedhore ka qenë e dobët në shumë raste sidomos KZAZ, të cilat kanë operuar pa axhenda të mirëpërcaktuara, me mosrespektim oraresh dhe me probleme komunikimi.<sup>64</sup>

Edhe shkalla e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet komponentëve përbërës të autoritetit zgjedhor ka qenë me probleme. Njëmbëdhjetë KZAZ janë shprehur të pakënaqura nga bashkëpunimi me KQZ-në dhe shtatë KZAZ janë shprehur të pakënaqura me asistencën e marrë nga autoritetet vendore për zgjidhjen e këtyre problemeve të evidentuara.<sup>65</sup>

Janë evidentuar raste të paraqitjes së ankimeve apo kontestimeve të cilat nuk janë pasqyruar në procesverbale ose për mosnjohje të kuadrit ligjor ose për shkak të qëndrimeve politike që mbajnë anëtarëve të KZAZ.<sup>66</sup>

Performanca e pamjaftueshme e autoriteteve zgjedhore është evidentuar edhe në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese me qytetarët.<sup>67</sup>

---

63 Raport i ndërmjetëm “ Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015”, KZLN

64 “Raport i ndërmjetëm monitorimi II, 27 Mars-21 Maj 2015”, KVV

65 Raport i ndërmjetëm “ Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015” KZLN

66 Raport monitorimi mbi drejtësinë zgjedhore 1 qershor - 10 gusht 2015 KVV

67 Gjetjet kryesore të vëzhgimit të procesit përgatitor për zgjedhjet vendore të 21 Qershorit, 2015; 4 Qershor, 2015

### **III. INDEKSI I PËRFSHIRJES SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE VENDORE TË 21 QERSHORIT, 2015**

#### **1. Rëndësia e Përfshirjes së Shoqërisë Civile në Zgjedhje**

OJQ-të të cilat monitorojnë zgjedhjet luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e tyre dhe mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe pozitivisht në rezultatin e procesit zgjedhor, promovimin e standardeve demokratike, të drejtave politike dhe mirë qeverisjes. Organizimi dhe përgatitja e duhur e OJQ-ve i krijon atyre avantazhe të dukshme krahasuar me vëzhguesit e huaj, pasi dinë kulturën politike, gjuhën dhe territorin. Po në këtë kontekst, rëndësia e rolit të OJQ-ve gjatë procesit zgjedhor lidhet edhe me faktorë të tjerë, siç janë numri i vëzhguesve, shtrirja territoriale e tyre, fokusimi në aspekte të caktuara të vëzhgimit të zgjedhjeve, ndjekja në vazhdimësi edhe pas përfundimit të procesit zgjedhor e problematikave të ndryshme me qëllim përmirësimin e procesit zgjedhor. Anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, si qytetarë mishërojnë idenë se shoqëria duhet të marrë përgjegjësinë kryesore për përmirësimin e proceseve të veta politike.

#### **2. Roli i Shoqërisë Civile Shqiptare në Zgjedhje**

Përfshirja dhe angazhimi i organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri në vëzhgimin dhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore i ka fillimet që pas viteve 1990, edhe pse në këtë periudhë numri i OJQ-ve ka qenë mjaft i kufizuar, rreth 2-3 organizata të tilla. Gjatë kësaj periudhe filloi krijimi, zhvillimi i kapaciteteve dhe përvojave të para të OJQ-ve të veçanta për vëzhgimin e proceseve zgjedhore, megjithëse numri i vëzhguesve ishte shumë i vogël dhe profesionalizmi i tyre në një nivel të ulët. Procesi zgjedhor monitorohej në mënyrë të pjesshme duke i kushtuar rëndësi më të madhe vëzhgimit të tij

vetëm ditën e zgjedhjeve dhe niveli i transparencës dhe pavarësia politike shpesh ishin një problem shqetësues.

Pas viteve 2000 numri i OJQ-ve të angazhuara në vëzhgimin e zgjedhjeve u rrit. Gjithashtu pati një bashkëpunim në rritje ndërmjet organizatave të cilat aktivizonin vëzhgues të pavarur. Në këtë kontekst një ndër bashkëpunimet e para ndërmjet organizatave ka qenë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, në Qershor 2001. Pas këtij bashkëpunimi në zgjedhjet vendore të vitit 2013, 18 OJQ shqiptare u prezantuan pjesëmarrëse në forumin e Vëzhguesve Vendorë Shqiptarë. Këto OJQ i vëzhguan së bashku zgjedhjet dhe gjetjet e tyre i prezantuan në një Raport të Përbashkët. Përvoja dhe eksperiencia e fituar, u zhvillua më tej gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare të datës 3 Korrik 2005. Organizatat anëtare të Forumit të Vëzhguesve Vendorë, në prag të këtyre zgjedhjeve i bënë thirrje të gjitha organizatave të tjera të bashkoheshin me iniciativën e tyre. Në këtë mënyrë u formua Koalicioni i Vëzhguesve Vendor (KVV),<sup>68</sup> i cili ka monitoruar dhe vëzhguar zgjedhjet që pasuan, si një ndër grupimet kryesore të shoqërisë civile që kanë vëzhguar proceset zgjedhore në Shqipëri. Gjithashtu në vitin 2012 KZLNDQ,<sup>69</sup> nisi veprimtarinë e saj duke u angazhuar në mënyrë aktive në vëzhgimin e zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2015.

### **3. Numri i Organizatave të përfshira dhe Shtrirja Gjeografike**


Zgjedhjet vendore të 21 Qershorit, 2015 u monitoruan në total nga rreth 53 organizata të shoqërisë civile në të gjithë Shqipërinë. Sikurse u citua edhe më lart, disa prej tyre janë organizata me një eksperiencë të gjatë në vëzhgimin e zgjedhjeve, ndërkohë që të tjera janë angazhuar për herë të parë nëpërmjet projekteve, nismave të tyre apo në kuadër të angazhimit si pjesë e koalicioneve të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve. Prej tyre 6 organizatave kanë një shtrirje të veprimtarisë në të gjitha qytet e vendit, ndërkohë që një numër prej 16 organizatash të shoqërisë civile të angazhuara në vëzhgimin e zgjedhjeve janë të vendosura vetëm në Tiranë. Përveç tyre, 23 organizata e zhvillojnë veprimtarinë vetëm në një qytet të caktuar të

<sup>68</sup> [www.zgjedhje.al](http://www.zgjedhje.al)

<sup>69</sup> [www.kzln.org.al](http://www.kzln.org.al)



vendit, 6 në Tiranë dhe njëkohësisht në një qytet apo më shumë dhe 3 në disa qytete përjashtuar Tiranën. Pjesë e kryesore e angazhimit dhe aktivitetit të organizatave vendore kanë qenë organizatat partnere të Koalicionit të Vëzhguesve Vendore (KVV)<sup>70</sup> dhe KZLNDQ.<sup>71</sup> Në këtë mënyrë organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet organizatave të tyre partnere janë munduar të sigurojnë një mbulim sa më gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor në Shqipëri.



*Grafik 5: Shtirja Gjeografike e Organizatave të Shoqërisë Civile të përfshira në vëzhgimin dhe vlerësimin e Zgjedhjeve Vendore të 21 Qershorit 2015 në Shqipëri.*

70 Të dhënat mbi 15 organizatat partnere lokale të KVV është marrë në faqen zyrtare të KVV më poshtë:

<http://www.zgjedhje.al/faqe.php?id=1&l2=98&gj=sh#>

71 Duke filluar nga 6 Qershori 2015, KZLNDQ përbëhet nga 30 organizata partnere anëtare <http://www.kzln.org.al/index.php/partneret>

#### 4. Aktivitetet e Kryera

Për të prezantuar gjetjet kryesore dhe rekomandimet e procesit të vëzhgimit të zgjedhjeve vendore 2015, organizatat e shoqërisë civile kanë përdorur tre qasje kryesore: 1) Raportet; 2) Nisma në kuadër të zgjedhjeve dhe 3) Qëndrime Publike/Zyrtare.

Organizata të caktuara, KVV, KZLNDQ dhe KShH kanë prezantuar raporte ndërmjetësimi dhe përfundimtare. Këto raporte janë prezantuar dhe bërë publike gjatë situatës para zgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe pas përfundimit të procesit zgjedhor, periudhë gjatë së cilës janë publikuar raporte përfundimtare. Organizata të tjera të angazhuara në vëzhgimin e zgjedhjeve vendore 2015, kanë publikuar raporte mbi tematika specifike të zgjedhjeve në kuadër të projekteve që këto organizata kanë zhvilluar. Mund të përmenden: Instituti Shqiptar i Studimeve Politike (ISP),<sup>72</sup> Partnerët Shqipëri,<sup>73</sup> Za’Lart,<sup>74</sup> Forumi i Mendimit të Lirë (FML), Rrjeti i Gazetarëve Shqiptarë të Politikës dhe Observatori për të Drejtat e Fëmijëve<sup>75</sup> & Qendra Ballkanike për Bashkëpunim dhe Zhvillim (BCCD). Në total numri i të gjithë këtyre raporteve mbi zgjedhjet 2015 ka qenë 20. (*Shtojca 1*) prezanton një përmbledhje të numrit të raporteve përgatitur dhe publikuar nga organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri në kuadër të zgjedhjeve vendore 2015.

Përveç prezantimit të këtyre raporteve të përgatitura dhe publikuara lidhur me zgjedhjet vendore 2015, organizatat janë shprehur edhe nëpërmjet prononcimeve/qëndrimeve publike, shkresave zyrtare apo takimeve të ndryshme në lidhje me çështje të standardeve të procesit zgjedhor. Në këto raste këto materiale janë publikuar si Shtojcë e Raporteve të zgjedhjeve apo nëpërmjet faqeve zyrtare të website-it. Organizatat i kanë prezantuar raportet mbi zgjedhjet edhe nëpërmjet konferencave/deklaratave për shtyp duke paraqitur konstatime të vëzhguesve të tyre apo duke u prononcuar për çështje të ndryshme.

72 [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)

73 [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

74 [www.zalart.al](http://www.zalart.al)

75 [www.observator.org.al](http://www.observator.org.al)

Ndërkohë organizatat e shoqërisë civile janë angazhuar gjatë procesit zgjedhor edhe nëpërmjet nismave të tjera të ndryshme. Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Zgjedhjeve (INSIZ) ka ndërmarrë nismën e krijimit për herë të parë në Shqipëri i Dhomës së Situatës Zgjedhore, një nismë e mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe drejtuar nga 7 anëtarët themelues të saj: Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), Instituti për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve (INSIZ), Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe të Ndryshme (KZLN), Instituti Shqiptar i Studimeve Politike (ISP), Qendra Info-ÇIP, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Forumi i Mendimit të Lirë (FML). Dhoma e Situatës Zgjedhore, u konceptua si një platformë koordinimi ndërmjet aktorëve të shoqërisë civile vendase, të angazhuar në vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri, e cila do të shërbente dhe bënte të mundur vëzhgimin e zgjedhjeve në kohë reale nëpërmjet një mekanizmi të shpejtë përgjigjeje ndaj problemeve që hasen gjatë procesit zgjedhor. Në të njëjtën kohë Dhoma Zgjedhore synoi të lehtësonte koordinimin e organizata të shoqërisë civile duke bërë të mundur adresimin e çështjeve të ndryshme në lidhje me zgjedhjet si një zë i vetëm. Gjatë aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Dhomës Zgjedhore, u zhvilluan tre konferenca. Në 7 Korrik, 2015 Dhoma Zgjedhore publikoi raportin përmbyllës të vëzhgimit të zgjedhjeve vendore 2015, objekt i të cilit ishte analiza e gjithë procesit zgjedhor dhe i cili evidentonte jo vetëm shkeljet dhe problemet prezente gjatë procesit zgjedhor 2015, por paraqiste edhe një sërë rekomandimesh për përmirësimin e tyre. Nisma të tjera në kuadër të zgjedhjeve janë zhvilluar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP),<sup>76</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH),<sup>77</sup> INFOÇP,<sup>78</sup> etj.

Megjithatë një angazhim më gjithëpërfshirës i OJQ-ve do ti jepte shoqërisë civile në Shqipëri një rol më të madh jo vetëm në zhvillimin e proceseve zgjedhore, por edhe në nevojën për të kaluar në një nivel më të lartë të përfshirjes së saj për realizimin e kapaciteteve në vëzhgimin e zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë në raportet e vëzhgimit të OSHC-ve do të duhej ti kushtohej vëmendje mbulimit dhe trajtimit edhe të tematikave të tjera, pjesë të procesit zgjedhor, sikurse edhe krijimit të një rrjeti më të qëndrueshëm bashkëpunëtorësh në të gjithë vendin.

76 “Pse Voton. Gjërat janë mirë kështu si janë!”

77 “Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në ushtrimin e të drejtës së votës në Zgjedhjet Lokale, Qershor 2015”;

78 [www.infocip.org](http://www.infocip.org)

## 5. Mbështetja Financiare

Pjesa më e rëndësishme e projekteve në lidhje me zgjedhjet vendore të 21 Qershorit 2015 u financuan nga donatorët ndërkombëtarë në Shqipëri (*Shtojca 2*). Një pjesë e tyre janë organizata apo programe ndërkombëtare të specializuara në fushën e vëzhgimit dhe vëzhgimit të zgjedhjeve, të cilat kanë patur një kontribut të gjatë dhe të hershëm lidhur me proceset zgjedhore në Shqipëri në veçanti: OSCE/ODIHR, UNDP, Këshilli i Evropës, USAID, Programi i Grandeve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, NDI etj. Mbështetja financiare ndërkombëtare ka synuar të nxisë përpjekjet e shoqërisë civile që adresojnë aspektet më të rëndësishme të procesit zgjedhor në Shqipëri. Këto aspekte janë fokusuar në fusha të ndryshme ndër të cilat me kryesoret mund të përmenden: 1) Asistencë teknike për KQZ-në; 2) Ofrimin e vëzhguesve vendorë; 3) Inkurajimin e angazhimit qytetar.

## IV. SHTOJCAT

### **Shtojca 1: Metodologjia e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve**





Për hartimin e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve është përdorur një metodologji e cila mat integritetin e zgjedhjeve nëpërmjet njëmbëdhjetë indikatorëve të procesit zgjedhor, duke filluar nga kuadri ligjor zgjedhor deri tek procedurat pas-zgjedhore.





Për të matur secilin indikator janë caktuar nga tre deri në gjashtë tregues të performancës. Në total janë dyzet e shtatë tregues të performancës. Secilit tregues të performancës i janë alokuar nëntregues të performancës.





Matja për treguesit dhe nëntreguesit e performancës është kryer me një vlerësim në katër shkallë: nga 1 në 4. Vlerësimi me 1 pikë i referohet shkallës më të ulët të performancës së indikatorit, ndërkohë që vlerësim me 4 pikë i referohet shkallës më të lartë të performancës së indikatorit.

Të dhënat e përdorura janë marrë nga raporte të prodhuara nga Organizata të Shoqërisë Civile që kanë mbuluar zgjedhjet vendore të vitit 2015. Të dhëna të tjera si statistika zgjedhore, rezultatet e zgjedhjeve, etj, do të përdoren kur është e nevojshme dhe e zbatueshme.





Tabela më poshtë përmban një përshkrim të plotë të indikatorëve dhe treguesve që do të përdoren për vlerësimin.




Indikatorët	Treguesit e Performancës	Nëntreguesit e Performancës	Vlerësimi për Treguesit e Performancës dhe Nëntreguesit	Vlerësimi për Indikatorët
1. Ligjet Zgjedhore	1-1 Ligjet zgjedhore kanë qenë të drejta ndaj partive politike të vogla;	1. Legjislacioni zgjedhor është i pranuar prej të gjitha palëve. 2. Legjislacioni zgjedhor ka besimin e shumicës së subjekteve në zgjedhje.	1 2 3 4	Dobët (1) 
	1-2 Ligjet zgjedhore nuk kanë favorizuar partinë ose partitë qeverisëse;	1. Në legjislacionin për regjistrimin e partive politike dhe/ose kandidatëve nuk ka kushte diskriminuese 2. Legjislacioni nuk kufizon hapësirën e subjekteve politike për të formuar koalicione parazgjedhore.	1 2 3 4	Mjaftueshëm (2) 
	1-3 Ligjet zgjedhore nuk kanë kufizuar të drejtat e qytetarëve;	1. Legjislacioni i plotëson standardet ndërkombëtare dhe siguron respektimin e të drejtave themelore të njeriut në mënyrë adekuate 2. Legjislacioni është i qartë, nuk është objekt interpretimesh dhe jep garanci të mjaftueshme për respektimin e të drejtave civile dhe politike.	1 2 3 4	Mirë (3) 
				Shumë mirë (4) 









2.Procedurat Zgjedhore	2-1 Zgjedhjet janë mirë menaxhuar;	<p>1.Nuk janë evidentuar incidente dhe probleme gjatë procesit zgjedhor.</p> <p>2. Është realizuar zbatimi i kërkesave të ligjit gjatë procesit zgjedhor.</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>4</p>	<p>Dobët (1)</p> 
	2-2 Informacioni mbi procedurat e votimit ka qenë gjerësisht i disponueshëm;	<p>1. Zgjedhësit janë informuar për procedurat e ndryshme të procesit zgjedhor.</p> <p>2.Nuk ka zgjedhës apo grupe zgjedhësish që nuk marrin ose nuk kuptojnë informacionin mbi zgjedhjet</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>4</p>	<p>Mjaftueshëm (2)</p> 
	2-3 Zyrtarët zgjedhorë kanë qenë të drejtë;	<p>1. Zyrtarët zgjedhorë janë të pavarur dhe nuk kanë qenë nën presion politik.</p> <p>2. Zyrtarë zgjedhorë që operojnë në qendrat e votimit kanë patur formim dhe eksperiencën e duhur.</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>4</p>	<p>Mirë (3)</p> 
	2-4 Zgjedhjet janë zhvilluar në përputhje me ligjin;	<p>1. Janë zbatuar dispozitat respektive ligjore mbi zgjedhjet.</p> <p>2. Zbatimi i legjislationit për subjektet zgjedhore nuk ka patur probleme.</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>4</p>	<p>Shumë mirë (4)</p> 





